Nga pedagogët e anketuar pjesa më e madhe e tyre japin mësim në disa cikle studimi përkatësisht, ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në ciklin Bachelor, Master i Shkençave dhe njëkohësisht dhe në Kolegjin Profesional të Lartë. Rreth 85 % e tyre japin mësim në ciklin e parë të studimeve Bachelor, pedagogë të angazhuar vetëm në Kolegjin Profesional të lartë përbëjnë rreth 22 %, ndërsa vetëm një prej të anketuarve nuk ka dhënë informacion mbi ciklin ku japin mësim.

Lidhur me grupin e dytë të pyetjeve, që i referohen *aspektit didaktik* të pyetur mbi frekuentimin e studentëve pjesa më e madhe e pedagogëve është shprehur *pozitivisht*. Pjesa më e madhe e pedagogëve 78.5 % shprehen se studentët frekuentojnë nga 61% - 90 % mësimin, dy prej tyre nuk kanë janë përgjigjur, 28 % e pedagogëve shprehen se studentët frekuentojnë nga 51 deri më pak se 50%.

Pyetjet drejtuar pedagogëve mbi strukturat didaktike të vendosura në dispozicion të tyre pjesa më e madhe e pedagogëve përgjigjen *pozitivisht*. Kështu rreth 78.5 % janë përgjigjur se kompletimi me mjete didaktike është "i plotë", dy prej tyre janë përgjigjur "mesatarisht i plotë" për kategorinë "projektorë". 89.2 % e pedagogëve shprehen se në institucion kanë akses të internetit dhe 75% e tyre e përdorin atë shpesh në procesin





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI" NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriaz.edu.al ,Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516



mësimor, ndërsa 6 prej tyre shprehen "ndonjëherë" dhe një person nuk ka dhënë përgjigje.

Të pyetur mbi hapësirën fizike të mjedisit të punës në shkallët e vlerësimit nga 1- 10 (ku 1 është vlera më e ulët është, ndërsa 10 vlera më e lartë), rreth 95 % e stafit shprehen nga shkalla 7-10, një person ka vlerësuar me shkallën 1. Lidhur me pyetjen e pedagogëve mbi vendosjen në dispozicion të tyre të pajisjeve të zyrave, mjeteve kancelerike dhe kompjutrave me vlerësim nga shkalla 1 – 10 rreth 95% e stafit shprehen nga shkalla 7 -10, pjesa tjetër ka vlerësuar me shkallën një, tre dhe katër.

Përsa i takon grupit të pyetjeve që lidhen me **marrëdhëniet me institucionin** të tilla si vlerësimin mbi përfshirjen e pedagogëve nga ana e strukturave në vendimmarrje me shkallë vlerësimi nga 1 deri në 10, afërsisht 89 % e pedagogëve kanë përzgjedhur nga shkalla 7 deri në 10, pjesë tjetër kanë përzgjedhur një shkallë vlerësimi nga 1 deri në 4 dhe afërsisht 6 % nuk i janë përgjigjur pyetjes.

Përgjigjet e pedagogët lidhur me vlerësimin e performancës së tyre nga titullari i gjeni të detajuara në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 3





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI" NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al ,Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

Lidhur me pyetjet për *trajtimin financiar* në lidhje me trajtimin financiar për punën e kryerjes me shkallë vlerësimi nga 1 deri në 10, 64 % e pedagogëve kanë vlerësuar nga shkalla 7 deri në 10, ndërsa pjesa tjetër kanë dhënë vlerësimin nga 1 – 6.

Lidhur me grupin e fundit të pyetjeve mbi *shprehjen e nevojës për përmirësimin e performancës* së tyre disa nga komentet kishin të bënin me dhënien më tepër të lirisë akademike, uljen e ngarkesës akademike dhe administrative, informimi me të rejt në fushat specifike, vendosjen në dispozicion të një fondi për kërkimin shkencor duke iu mundësuar atyre botime, vendosjen në dispozicion të literaturës bashkëkohore dhe zgjerimin e bibliotekës me tituj të rinj, si dhe korrektesa në paga.

Si përfundim mund të thuhet se mendimet e pedagogëve ishin kryesisht positive në lidhje me studentët, strukturën e kolegjit dhe mjeteve didaktike në dispozicion të tyre.

Disa nga sugjerimet e pedagogëve lidheshin me krijimin e një sistemi online për institucionin. Vendimarrjet të jenë kolegjiale lidhur me komponentet e procesit mësimor, planen mësimore etj.

b. Organizimi i Pyetësorit për Studentët

- Ky pyetësor mbështetur dhe në Statutin dhe Rregulloren e KUQ është organizuar çdo semestër dhe pëmban jo vetëm pyetje për pedagogët, por edhe ato lidhur me leksionet, komunikimin student - pedagog, si dhe infrastrukturën mësimore etj. duke synuar marrjen e mendimeve të tyre për aspektet kryesore të zhvillimit të performancës dhe cilësisë të procesit të mësimdhënies dhe veprimtarime shkencore në KUQ.
- Referuar planit të miratuar të NJSBC pyetësorët janë shpërndarë fizikisht.
- Të gjithë pyetësorët janë përpunuar dhe rezultatet i janë paraqitur me shkrim rektorit dhe për dijeni dekanëve të fakulteteve dhe drejtorit të Kolegjit Profesional të Lartë.

Gjatë zhvillimit të procesit mënyra e menaxhimit të pyetësorëve ishte transparente dhe





KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"
NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË


Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al ,Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

përzgjedhja e studentëve ishte e rastësishme. U respektua një kohë e përshtatshme për kryerjen e pyetësorëve, ku studentët plotësuan me vullnet të lirë dhe të plotë rubrikat e pyetësorëve.

Pyetësi i përdorur për studentët është miratuar me vendim senati. Pyetësi përmbante 5 pyetje të mbyllura dhe një pyetje të hapur me qëllim vlerësimin e rregullsisë së kryerjes së procesit mësimor, përmbajtjeve lëndore si për leksionet dhe seminarët, nxitjes nga pedagogu të mendimit kritik natyrisht duke dhënë vlerësimet dhe sugjerimet. Në përgjithësi leksionet në secilin prej kurseve kanë rezultuar të qarta të bazuar në një formim shkencor të kënaqshëm dhe profesional duke i bërë programet e këtyre kurseve interesante dhe tërheqëse për studentin. Numri i studentëve pjesëmarrës sipas programeve të studimit paraqitet në grafikun e mëposhtëm

Grafiku 4

Viti akademik 2023 - 2024



Lidhur me pyetjen nëse janë të kënaqur me pedagogët dhe raportin me ta, studentët e fakulteteve dhe të KPL brenda IAL shprehen "shumë" dhe nuk kanë sugjerime.





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI" NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al, Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

Pyetjes drejtuar në lidhje me kryerjen e leksioneve dhe seminareve studentët shprehën pozitivisht dhe nuk kanë sugjerime.

Lidhur me infrastrukturën ata shprehën se ndihen mirë me hapësirat dhe ofrohen facilitete. Shqetësimi i studentëve ngritur në pyetësorët për vitin akademik 2023 – 2024 lidhet me vonesën e akreditimeve. Shprehur kjo nga studentët e Fakultetit të Edukimit, Shkencave sociale dhe Sportit

Një problematikë po e shprehur nga studentët lidhet me pasjen e një sistemi online dhe me pasurimin e bibliotekës së IAL me tituj të rinj.


c. Raporti semestral për çdo pedagog.

Relacioni në mbyllje të sezonit të provimeve të Semestrit të I-rë dhe të II-të për realizimin e programeve të lëndëve nga çdo pedagog, ku sipas raportit semestral aty pasqyrohen përmbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës (syllabusit), pjesëmarrja, kalueshmëria, nota mesatare, mendime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit mësimor për të ardhmen, etj. nuk është dorëzuar nga të gjithë pedagogët, sikundër nuk janë zbatuar afatet e dorëzimit nga ata që e kanë dorëzuar

Sipas raportimeve të dorëzuar janë aplikuar metoda e të mësuarit aktiv, duke ndërthurur dimensionin teorik me atë praktik për rritjen e nivelit tekniko-profesional të studentit.

Standardet e respektuara, rezultuan të jenë:

1. Është realizuar një proces shpjegimi në formate powerpoint, excel, pdf apo materiale Word.
2. Leksionet apo seminarët/ushtrimet janë realizuar sipas orëve të miratuara në planin mësimor.
3. Studentët përmes këtij procesi kanë patur mundësi të aksesojnë leksionet edhe në formë elektronike





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI" NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al ,Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

Disa prej pikave të forta të raportuara nga vetë stafi akademik në relacionet e paraqitura pranë Koordinatorit të NJSBC për FD., FE., FESHSS si dhe KPL .

- Angazhim maksimal të administratës, personelit përgjegjës për teknologjinë apo bibliotekën etj, për të shfrytëzuar maksimalisht kanalet e komunikimit.
- Angazhim i studentëve gjatë ndjekjes së leksioneve dhe seminareve me pedagogët përkatës.
- Angazhim maksimal nga ana e stafit akademik në përcjelljen e informacionit lëndor, duke shfrytëzuar dhe e-maillet etj.
- Feedback-u i studentëve deri më tani pozitiv dhe me vlerësime mbi punën e kryer nga stafi akademik dhe drejtuesit e Njësive Kryesore.

Disa prej pika të dobëta të evidentuara kanë qenë:

Mosangazhimi i studentëve në punë të pavarur dhe detyrat e kursit

d. Performanca e studentëve.

Vëzhgohet përmes vënies në funksionim të një mekanizmit monitorues. Ky mekanizëm në vetëvete përbën edhe një gjetje apo tregues të cilësisë dhe mbështetet mbi pesë shtylla apo elementë që konsistojnë në:

- Vijueshmërinë e tyre në leksione, pjesëmarrjen dhe angazhimin në zhvillimin e debatit dhe të shkëmbimit të opinioneve në grupe gjatë orëve të seminarit.
- Nivelin cilësor të angazhimit të tyre në procesin e debatit dhe shkëmbimit praktik të opinioneve gjatë zhvillimit të orëve të seminareve, përmes ballafaqimit të kazuseve nga praktika gjyqësore, administrative, si dhe në biznese.
- Përmes organizimit të Detyrave të Kursit, shpërndarjes së tematikave synohet reagimi i studentëve, duke rritur ndjeshëm shanset e identifikimit të nivelit të cilësisë së tyre në lidhje me shprehjen dhe kohezionin e dijeve dhe të arritjeve të tyre akademike.
- Kolokiumeve semestrale: Në hartimin e tezave në këtë ballafaqim student-





KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"
NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al, Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

pedagog" i është kushtuar vëmendje e veçantë arritjes së vlerës praktike të tezave. Mënyrat e testimit kanë krijuar avantazh të padiskutueshëm si për studentin, i cili ka pasur në posedim hapësirën e nevojshme shprehëse të dijeve të tij, ashtu dhe për pedagogun që ka ushtruar në mënyrë të ndërsjellët një kontroll më të gjerë dhe më efikas mbi përgatitjen e studentit.

- Provimi përfundimtar është realizuar me anën e provimit të përgjithshëm, apo të punimit për mbrojtjen e diplomës.

e. *Ndihma e ndërsjellë ndërmjet pedagogëve, shkëmbimi i eksperiencave.*

- Element i rëndësishëm i veprimtarisë së NjSBC është: vlerësimi edhe ndihma e ndërsjellë ndërmjet pedagogëve dhe shkëmbimi i eksperiencave mbi metodologjinë e mësimdhënies.
- Janë organizuar nga ana e FD trajnime me pedagogët e rinj për metodologjinë e mësimdhënies dhe për probleme të tjera që do ti shërbejnë rritjes së cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies, në funksion të rritjes së cilësisë së procesit mësimor.

f. *Veprimtaria kërkimore shkencore e stafit si dhe mundësi për angazhim të studentëve.*

KUQ angazhon në kërkimin shkencor profesorë me tituj dhe grada si pjesë e personelit akademik, duke u kujdesur njëkohësisht që në kete proces të përfshije gradualisht me standartet e duhura brezin e ri të pedagogeve me synimin në rritjen dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre, Ndër indikatorët e kualifikimit akademik janë: Gradat dhe titujt shkencore; Eksperiencia në fushën e mësimdhënies; Eksperiencia profesionale; Botime akademike; Kualifikimet ekstra kurrikulare; etj.,

Në bashkëpunim me QKSH dhe ZMJP&KK është miratuar formati mbi raportimin e veprimtarisë për kërkime shkencore të stafit për vitin akademik 2023 - 2024, duke patur si qëllim forcimin e mekanizmave për të rritur dhe zhvilluar angazhimin e stafit në aktivitete shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI" NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al ,Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

Në FD si pjesë e personelit akademik disa anëtarë janë në proces për marrjen e gradës shkencore Doktor i shkencave. Gjatë vitit akademik 2023 - 2024 një anëtar i departamentit të FD ka filluar procesin për marrjen e gradës "Doktor i shkencave". Një nga anëtarët (PAE) e po këtij departamenti ka marrë titullin "Profesor i Asociuar"

Në FE si pjesë e personelit akademik (PAE) disa anëtarë janë në proces për marrjen e gradës shkencore "Doktor i shkencave". Gjatë vitit akademik 2023 - 2024 një anëtar i departamentit të FE ka filluar procesin për marrjen e gradës "Doktor i shkencave". Një nga anëtarët (PAE) e po këtij departamenti ka marrë titullin "Profesor"

Keta pedagogë kanë gjetur mbështetjen nga institucioni si nga ana financiare ashtu edhe nga shpërndarja kohore e punës për të realizuar objektivat, pa ndalesa në detyrimet financiare të parashikuara në kontratë. Realizimi i veprimtarive kërkimore-shkencore nga ana e strukturave drejtuese dhe përgjegjëse për kërkimin shkencor ka patur mbështetje maksimale për pjesëmarrje në aktivitete shkencore të realizuara fizikisht/virtualisht apo botime në revista me faktor impakti krahas një numri të konsiderueshëm aktiviteteve të realizuara në ambjentet e KUQ. Të dhëna përmbledhëse për përfshirjen e stafit dhe studentëve në aktiviteteve të zhvilluara për vitin 2023 – 2024 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 12

Përfshirja projekte	Leksione të hapura kombëtare	Leksione të hapura ndërkombëtare	Konferenca kombëtare/ndërkombëtare	Professor të ftuar	Përfshirja studenteve ne Trajnime/Mobilitet/ Konferenca
1	5	4	3/20	6	





KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"
NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al , Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

Tabela 13

Aktivitete individuale të stafit akademik viti akademik 2023-2024		
1.	Numri i botimeve monografi nga personeli akademik	6
2.	Numri i botimeve në revista shkencore nga personeli akademik	14
3.	Numri i projekteve kërkimore të fituara në shkallë Departamenti/Fakulteti	1
4.	Numri i projekteve të zbatuara në shkallë Departamenti/Fakulteti	0
5.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga KUQ	9
6.	Numri i pedagogëve pjesëmarrësve në aktivitete shkencore	12
7.	Numri i Çmimeve Kombëtare të fituara në rang IAL	0

Aktivitete shkencore gjatë vitit akademik 2023 – 2024

Në përmbushje të objektivave të veta ZMJP&KK ka përmbushur objektivat e parashikuara në programin vjetor të veprimtarive Kërkimore Shkencore për vitin akademik 2023 - 2024. Gjatë vitit akademik 2023 - 2024 ka organizuar:

Leksione të hapura me profesorë vendas: ZMJP & KK ka organizuar në muajin Prill, 2024 leksionin e hapur me temë "Institucionet Ndërqeveritare dhe Sporti: Shembull i hartimit të një Karte Sportive" referuar nga Z. Kolë Gjeloshaj, Menaxher Ndërkombëtar, si dhe anëtar i Federata Ndërkombëtare e Sporteve, ku morën pjesë pedagogë dhe studentë FESHSS.

Leksione të hapura me profesorë të huaj: ZMJP & KK në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit ka organizuar në muajin Nëntor 2023 leksionin e hapur me temë "Njohuri në lidhje me sportin e Padel-it dhe potencialin e tij për zhvillim personal dhe profesional" referuar nga Z. Alessandro Pallini, CEO Albania Padel.





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR “QIRIAZI” NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al, Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

Trajnim i Stafit të KUQ: Stafi i Kolegjit Universitar “Qiriazi” gjatë muajit Nëntor 2023 në Kuadër të Trajnimeve për Zhvillimin e Vazhduar Profesional ka kryer një trajnim katër ditor me Prof. Asoc. Leticia GUSHO me temën “Metoda mësimdhënie për zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë”


Konferenca: ZMJP & KK gjatë vitit 2024 në dy nga konferenca ndërkomëtare realizuar në KUQ ka patur tri referues ndërkombëtare në Konferencën Ndërkombëtare mbi Turizmin dhe Hotelerinë ka refruar PhD Ádám Lovassy, Chargé d’Affaires (Head of Mission) Embassy of Hungary in Tirana me temë “ Turizmi dhe Hoteleria”, ndërsa në Konferencën Ndërkombëtare në Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet kanë refruar Prof. Antonio Imeneo, IRC UniFUNVIC EU, Sports Academy, International Center for Prevention and Treatment Sport and Human Rights dhe Rachele Megna, UN Women me temën “Gratë dhe Vajzat në sporte, në Shqipëri”

4.4 Vlerësimi dhe të dhëna mbi ecurinë e punës kërkimore shkencore të personelit akademik sipas Fakulteteve

Monitorimi dhe raportimi i të dhënave mbi kualifikimin dhe rritjen akademike dhe shkencore të personelit akademik që mbulon Programet e Studimit që ofrohen në IAL-në tonë lidhet me planin strategjik të zhvillimit të KUQ, i cili përsa i përket Personelit Akademik dhe prioriteteve në kualifikimin e personelit akademik ka si objektiva:

Zhvillimin dhe zbatimin e politikave rekrutuese transparente për një personel akademik sa me kualitativ. Zbatimin e politikave që nxitin rritjen e performancës së personelit dhe kërkimit shkencor. Krijimin e një mjedisi të shëndetshëm e miqësor në Kolegj. Nxitja e mendimit dhe diversitetit akademik e shkencor të personelit akademik. Nxitja dhe krijimi i mundësive për lëvizjen e stafit në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

KUQ gjatë vitit 2023 – 2024 ka angazhuar në kërkimin shkencor pedagogë me tituj dhe grada si pjesë e stafit akademik, duke u kujdesur njëkohësisht që në këtë proces të





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"

NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al, Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

përfshijë gradualisht me standardet e duhura brezin e ri të pedagogëve me synimin në rritjen dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre. Ndër indikatorët e kualifikimit akademik mbeten:

- Gradat dhe titujt shkencore;
- Eksperienca në fushën e mësimdhënies;
- Eksperienca profesionale;
- Botime akademike;
- Kualifikimet ekstra kurrikulare;

Në zbatimin e këtyre objektivave janë angazhuar strukturat përkatëse të institucionit, si njësitë bazë të cilat monitorojnë aktivitetin shkencor të personelit akademik, si edhe njësi mbështetëse, që ndërveprojnë aktivitetin shkencor të personelit sikurse është Njësia e Kërkimit Shkencor dhe me marrëdhëniet me Jashtë, (ZMJP&KK), NJSBC dhe Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNJ)

ZMJP&KK është struktura, e cila në bashkëpunim me NJSBC, mbështetur në rregulloren e saj mbi koordinimin dhe monitorimin e cilësisës së procesit të mësimdhënies, ku përfshihet rritja akademike dhe shkencore e personelit akademik ka ndertuar mekanizmat e duhur për të arritur këtë objektiv. Konkretisht NJSBC ka miratuar "Formularin për Vlerësimin e Kapaciteteve Njerëzore në Fushën Akademike e Kërkimore-Shkencore" i cili është aplikuar nga ZMJP&KK. Ky formular është i detyrueshëm për t'u plotësuar në formë periodike një here në vit. Në rast kërkesash specifike nga institucionet monitoruese të IAL-së ose në rast procesi akreditimi, raportit të dhënave për personel akademik realizohet nga ZMJP&KK për periudha më të gjata kohore në Dekanat ose Rektorat.

Gjithashtu një tjetër njësi me të cilën realizohet koordinimi lidhur me të dhënat e kualifikimeve të personelit akademik është ZBNJ, ku raportohet për çdo kualifikim nga ana e stafit akademik, si marrja e gradave shkencore ose titujve shkencore, materialet






KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI" NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al ; Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516


certifikuese të punës kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe dokumentacionin përkatës nga ana e personelit akademik në dosjet e tyre personale të punës. Sipas të dhënave nga ZMJP & KK pjesëmarrja e pedagogëve në aktivitete shkencore sipas fakulteteve është paraqitur në grafik:

Grafiku 5



Ndërlidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Synimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore duhet të jetë ngritja e vazhdueshme e standarteve akademike në KUQ dhe përmirësimi sistematik i cilësisë së arritjeve të studentëve. I gjithë stafi akademik duhet të angazhohet në procesin e integritetit të rezultateve të punës së tyre kërkimore-shkencore në procesin mësimor (leksione, seminare, monografi shkencore etj.) Për këtë qëllim janë organizuar seminare dhe tryeza diskutimesh akademike, me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve. Në këto veprimtari anëtarët e stafit akademik përditësojnë njohuritë e studentëve me të rejtat nga veprimtaria e tyre hulumtuese duke i ndihmuar ata në përsosjen e kompetencave në përputhje me fushat e ekspertizës.





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI" NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al, Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

Workshop:

Gjatë vitit akademik 2023 - 2024 është realizuar për studentët e KUQ Workshop me temën "Përgatitje për intervistë pune"

Lista e konferencave shkencore, ku Kolegji Universitar "Qiriazi" ka qenë organizator dhe bashkëorganizator gjatë vitit akademik 2023 – 2024:

- International Conference on Agriculture and Life Sciences "ICOALS IV" (1-3 nëntor 2023, Tiranë, Shqipëri). Website: <https://icoals4.com/>
- International Conference on Physical Education, Sport and Health (11 prill 2024, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë). Website: <https://qiriazi.edu.al/konferenca-nderkombetare-ne-edukim-fizik-sport-dhe-shendet-2/>
- International Conference on Tourism and Hospitality (30 maj 2024, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë). Website: <https://qiriazi.edu.al/konferenca-nderkombetare-mbi-turizmin-dhe-hotelerine/>
- 7th International Conference on Social Science Research (4-6 shtator 2024, Durrës, Shqipëri). Website: <http://iconsr.org/>
- 7th International Conference on Engineering Science and Technology (4-6 shtator 2024, Durrës, Shqipëri). Website: <https://iconst.org/Page/ESTconference>
- 7th International Conference on Life Science and Technology (4-6 shtator 2024, Durrës, Shqipëri). Website: <https://iconst.org/Page/LSTconference>
- 7th International Conference on Natural Science and Technology (4-6 shtator 2024, Durrës, Shqipëri). Website: <https://iconst.org/Page/NSTconference>

Projekte kerkimore: QKSH, ZMJP &KK janë përfshirë në projekte kerkimore pedagogu Vilielm Kurtulaj drejtues i ZMJP& KK. Projekti titullohet " **Women's Economic Empowerment through Gender Sensitive Value Chain Interventions**. Ky projekt ka si organizator kryesor Qendrën Aleanca Gjinore për Zhvillim. Projekti u zhvillua gjatë gjithë vitit 2023 dhe u finalizua në nëntor të 2023. Nga Kolegji Universitar Qiriazi, në këtë projekt është i përfshirë në rolin e ekspertit z. Vilielm Kurtulaj si drejtuesi i Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Menaxhimit të Projekteve. Qëllimi i këtij projekti është fuqizimi i grave sipërmarrëse në qarkun e Tiranës dhe përgatitja e një grupi ekspertësh si trajnerë dhe ekspertë të





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI" NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al, Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

ardhshëm në analizën e zinxhirit të vlerës me ndjeshmëri gjinore. Projekti mbështetet financiarisht nga Fondi i Veprimit për Barazi Gjinore (GEEA) i Departamentit të Shtetit të ShBA-ve. Projekti është finalizuar në nëntor të 2023 shoqëruar me publikimin e raportit përfundimtar.


Trajnim: në kuadër të "EYFON YouthDays". Partner Regions of Styria meet at Europaburg Castle 30-35 young Europeans (18-25 years) from the Western Balkans, Italy, France, Croatia, Slovenia, Hungary, Ukraine u zhvillua trajnimi pesë ditor në Steiermark, Austri, ku u bë pjesë edhe Kolegji Universitar "Qiriazi". Në fokus të këtij trajnimi ishin çështje si: edukimi, aftësitë e të ardhmes, pikat e forta personale, kompetencat interkulturore dhe programet e mobilitetit në EU.

V. VLERËSIMET TË INSTITUCIONIT MBI SIGURIMIN E CILËSISË DHE REKOMANDIME

Institucioni ynë ndodhet në fazën e zhvillimit të mëtejshëm dhe konsolidimit të standardeve dhe mekanizmave ekzistuese të cilësisë në kuadër hapësirës mbarë evropiane të Arsimit të Lartë por edhe të përafrimit të politikave dhe strategjive të reja në lidhje me kriteret e cilësisë. Proceset, që kanë karakterizuar politikën e cilësisë gjatë vitit akademik 2023 -2024 nga KUQ mund të veçojmë:

- a. Aktivitetet e mësimdhënies;
- b. Aktivitete të karakterit kërkimor-shkencor;
- c. Performanca e studentit;
- d. Marrëdhëniet me jashtë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- e. Akreditimi periodik institucional dhe procese të tjera akredituese në nivel programor.

Lidhur me *mësimdhënien*, janë konsoliduar përpjekjet për zhvillimin cilësor të leksioneve dhe seminareve dhe krijimi i një atmosferë sa më bashkëkohore, ku padyshim teknologjia si dhe metodat e adoptuara luajnë një rol parësor.





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI" NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË


Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al, Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

Gjatë vitit akademik 2023 - 2024, KUQ përmbushi synimet e planifikuara, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore. Në lidhje me elementin e *aktiviteteve kërkimore-shkencore*, ka pasur një politikë konstante në lidhje me zhvillimin dhe zgjerimin e hapësirave kërkimore shkencore brenda institucionit tonë, duke mundësuar pedagogëve botimin në revistën shkencore "Kyrias" dhe pjesëmarrjen në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare organizuar nga institucioni.

Lidhur me *performancën e studentëve* është adoptuar formula që siguron një zhvillim të vazhdueshëm të performancës së studentit, si dhe rritje të cilësisë së bashkëveprimit student – pedagog. I gjithë personli akademik angazhohet në procesin e integritit të rezultateve të punës së tyre kërkimore- shkencore në procesin mësimor (leksione, seminare, monografi shkencore etj.) Për këtë qëllim, të organizohen seminare dhe tryeza diskutimesh akademike, me pjesëmarrjen e përbashkët të personelit akademik dhe studentëve. Në këto veprimtari anëtarët e personelit akademik përditësojnë njohuritë e studentëve me të rejtat nga veprimtaria e tyre hulumtuese dhe ndihmojnë në mjeshtërimin e kompetencave në përputhje me fushat e ekspertizës. Performanca e studentëve gjatë këtij viti akademik është realizuar përmes vënies në funksionim të mekanizmave monitorues dhe rezultatet e arritura janë të përmendura edhe më sipër në këtë raport.

Për sa i përket *marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe marrëdhënive me jashtë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar*, mund të cilësojmë se KUQ po zhvillon përpjekjet e tij për shtrirjen e projekteve të bashkëpunimit dhe anëtarësimit me IAL brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunimi me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, angazhime në projekte të ndryshme, zgjerimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani të mirënjohura biznesi, institucione dhe sektorë publik etj.,

Aktualisht regjistrohen 104 marrëveshje bashkëpunimi, binjakëzime dhe memorandume mirëkuptimi në nivel institucional, me shkolla të larta, universitete, akademi, kompani private, studio ligjore, institucione shtetërore, organizata jofitimprurëse dhe shoqata të





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI" NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al , Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

ndryshme. Nga këto marrëveshje 86 janë me institucione brenda vendit dhe 18 me institucione jashtë vendit. Për zhvillimin e marrëdhënieve me jashtë të institucionit tonë fusha e veprimit përfshijnë:

1. Përafrimin e programeve të lëndëve me standardet e universiteteve perëndimore;
2. Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL të ndryshme (kryesisht ato perëndimore) dhe qendra kërkimore apo institute të kërkimit shkencor;
3. Shkëmbimi i përvojave në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
4. Nxitja e punës kërkimore tek stafi dhe mbështetja e stafit për punën kërkimore dhe sigurimi i pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete ndërkombëtare shkencore, konferenca ndërkombëtare shkencore, botime në revista me faktor impakti etj;

Lidhur me *Akreditimin periodik Institucional si dhe akreditime të tjera programore përgjatë vitit akademik 2023 – 2024*, KUQ realizoi procesi i riakreditimit periodik institucional dhe programeve të tjera që janë trajtuar në fillim të këtij raporti, po duhet theksuar fakti se IAL jonë ka vlerësuar maksimalisht këtë proces duke e trajtuar me seriozitet si dhe duke marrë të gjitha hapat e duhura për mbarëvajtjen e procesit por edhe dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar brenda të gjitha afateve të parashikuara në Legjislacionin për Arsimin e Lartë në RSH.

Për sa i përket *këndvështrimit të NJSBC*, gjykojmë që disa prioritete duhet të mbahen nën një konsideratë të vazhdueshme:

- Duhet të përmirësohen linjat e komunikimit, si në aspektin e personelit akademik me njëri-tjetrin ashtu edhe ndërmjet këtyre të fundit me studentët.
- Të bëjë më tepër përpjekje dhe të gjejë hapësira në përfshirjen e pedagogëve në vendimmarrje në funksion të inkurajimit dhe bashkëpunimit të brendshëm institucional.

